

QEMAL HAXHIHASANI

TREGIME POPULLORE RRETH PERIUDHËS SË SKËNDERBEUT

Ngjarjet heroike të kohës së Skënderbeut u ruajtën jo vetëm në gjuhën e kronikave dhe të veprave të historianëve, por edhe në zërin e gjallë të traditës — të gojëdhënave dhe të kujtimeve popullore —, që fjetuan ndër shekuj, duke u përcjellur gojë më gojë nga një brez në tjetrin. Në këto kujtime e gojëdhëna masat tona popullore kanë perceptuar në mënyrë të vetvetishme faktet historike, kanë fiksuar mbresat, ndjenjat e tyre të mëdha, jehonën e një periudhe, kur populli ynë me luftat e tij legjendare i qëndroi si shkëmb rrebeshit turk, që kërkonte të vërshonte nëpër botë. Këto tregime kanë në qendër të vëmendjes figurën e heroit vigan Gjergj Kastriotit-Skënderbeut, i cili e udhëhoqi popullin tonë me vendosmëri për 25 vjet me radhë në këto beteja heroike, ku shkëlqyen aftësitë morale e luftarake, patriotizmi, energjitë e pashtershme të masave tona popullore. Rreth figurës së tij janë përqëndruar ngjarjet më të rëndësishme të kohës, janë mishëruar tiparet e një udhëheqësi të madh popullor, janë përgjithësuar virtytet e larta të tërë një populli. Si një simbol i qëndrësës, i heroizmit dhe i luftave ngadhnjimtare për liri, tradita popullore për Skënderbenë përbën një thesar shumë të çmuar të ndërgjegjes patriotike të popullit tonë, një dokument të shkëlqyer, që dëshmon se fama e Skënderbeut nuk u ruajt «vetëm nga jashtë» siç duan të thonë armiqtë e vendit tonë, por u skalit si në mermer në zemër të kombit nga vetë ata që e farkëtuan këtë epike të lavdishme. Ato tregojnë se sa pa baza janë tezat e gjithatyre që kanë dashur të mohojnë traditat liridashëse, vlerat dhe aftësitë krijuese të popullit tonë, të Gjorgjeviqëve, Gjurkoviqëve etj., të cilët kanë pretenduar se shqiptarët nuk qenë të zot të frymëzoheshin dhe të krijonin një letërsi gojore rreth heroit të tyre kombëtar.

Periudha e Skënderbeut popullit tonë i ngjalli emocione të mëdha, i ndezi zemrën, e frymëzoi për krijime që shprehin ndjenja të një patriotizmi të thellë. Me të drejtë mund të thuhet se rrallë popuj kanë mundur të ruajnë nëpërmjet të traditës kuadrin e një periudhe, sado të shkëlqyer të historisë së vet kaq gjatë, me kaq realizëm dhe aspekte polidrike si populli ynë. Emri i Skënderbeut, i këtij hero, që u shqua si «më i madh dhe më i rrebt i luftëtar, që nxori lufta e Evropës me turqit», kaloi në legjendë që me gjalljen e tij. Humanisti ynë Marin Barleti, në veprën monumentale që hartoi për heronë, veç kujtimeve të veta dhe burimeve të shkruara, shfrytëzoi edhe burimet gojore. Legjendat për parashikimin e forcës së mrekullueshme të Skënderbeut si edhe të dhënat rreth lartësimit të fitoreve të tij nëpër këngël, të cilat autori ynë duhet t'i ketë njohur nëpër vise të ndryshme të atdheut, flasin qartë për pikënisjen dhe vazhdimësinë e kësaj tradite. Po për një fakt të tillë de-

1) M. Barletius, *Historia de vita et gestis Scanderbegi*. Romae 1508-1510. Citimet këtu dhe më poshtë sipas botimit shqip. Tiranë 1964: f. 3, 50, 51, 113, 169, 216, 255, 282, 283.

shmojnë edhe autorë të tjerë si A. Sabeliko², Dhimitër Frangu³, etj. Kujtimi i luftimeve të «motit të madh të Arbërit» dhe emri i Skënderbeut nuk u shua asnjëherë nga zemra e popullit tonë; përkundrazi ai u ruajt si një kujtim i shtrenjtë, që shërbeu si një flamur që frymëzonte masat tona popullore në përpjekjet e tyre çlirimtare. Budi shkruante më 1621 se «zjarri i kryengritjes ish i ndezur në krahinat që njiheshin në popull me emrin **Viset e Skënderbeut**»⁴. Frano Bardhi në **Apollogjinë**, që hartoi, për të hedhur poshtë shpifjet e Tomkut, peshkopit boshnjak, i cili ish përpjekur t'i mohonte kombit shqiptar heroin e tij të madh, theksonte midis së tjerash: «Vazhdimisht bashkëkombasit tanë flasin për Skënderbeun dhe këndojnë me zë të lartë trimëritë e tij nëpër gos-titë». ⁵ Deri udhëtari turk i shekullit XVII Evlia Çelebia shënon në veprën e tij se një lagje në qytetin Çhër mbante emrin e Skënderbeut⁶. Për vazhdimësinë e traditës popullore rreth heroit nëpër shekuj na flasin edhe një tog autorësh të tjerë si M. Bici, Pukëvili, A. Buë, Hekardi, Degradi etj. Por ai që u ndal në mënyrë të veçantë për kapjen dhe zbulimin e kësaj tradite që albanologu i njohur J.G. Hahn, i cili vizitoi krahinat tona të veriut Krujën, Matin etj. më 1863. Hahn flet për ekzistencën e toponimeve me emrin e heroit si **Mali Skanderbeg e Qafa e Skanderbegut** (midis Matit e Krujës), **Varoshi e Qyteti i Skanderbegut** në Mat⁷; për zbatimin e kanunit të **Skanderbegut** dhe për motivet interesante të gojëdhanave rreth heroit tonë, të cilat i krahason me sagat gjermanike, sidomos me ato të mbretit të Gotëve, Teodorikut, duke u përpjekur të gjejë ndër ta sipas teorive krahasimtare, që ishin në vogë në atë kohë, një burim të përbashkët indoeuropian⁸.

Evokimi i figurës së Skënderbeut dhe i kohës së tij në periudhën e Rilindjes, si simbole të rezistencës së madhe të popullit shqiptar kundër pushtimit turk, bënë që krahas trajtimit të këtyre temave në veprat letrare të përqëndrohej vëmendja edhe në krijimet artistike (gojëdhana etj.) të ruajtura përmes shekujve nga tradita popullore. Nisën atëherë botimet e para të elementeve të kësaj tradite, që kish jetuar e gjallë në krahina të ndryshme të vendit tonë, duke kaluar si një stafetë fitoresh të lavdishme nga një brez në tjetrin përmes shekujve të robërisë otomane.

Folkloristët arbëreshë kishin filluar të botonin këngë mbi heroin që nga mezi i shekullit XIX, por tema e krijimeve popullore në prozë rreth Skënderbeut mbeti për ta një fushë pothuajse e paprekur. Elementet e dhëna nga A. Stratikoi (1896)⁹ dhe A. Lorekio (1898)¹⁰ më tepër gjëra të rastit, që nuk flasin për një gjini të lëruar gjerësisht. Sikurse do të trajtohet edhe më poshtë gojëdhënat dhe kujtimet popullore rreth Skënderbeut jetojnë tek ne të lidhura ngushtë me ve-

2) A. Sabeliko, *Historiae Rerum Venetarum...* Basileae 1570 f. 568 (Botim i parë 1487).

3) D. Franco, *Gli illustri et gloriosi gesti....* Vinegia 1584 f. 83, 85.

4) *Relacione mbi gjendjen e Shqipërisë veriore dhe të mesme në shek. XVII vëll. I* f. 301.

5) F. Blancus, *Georgius Castriotus...* Venetiis 1636. Citimi nga botimi shqip. Tiranë 1957: f. 73.

6) E. Çelebia, *Shqipnija para dy shekujsh*. (Përkth. shqip) Tiranë 1930 f. 126.

7) J.G. Hahn, *Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar*, Wien 1869 f. 8, 10, 11, 14.

8) J.G. Hahn, *Reise durch die Gebiete des Drin und Wardar*. Wien 1867 f. 19, 20, 21, 25.

9) A. Stratico, *Manuale di letteratura albanese*. Milano 1896 f. 127

10) A. Lorechio, *Nazione albanese* 1898, 16/8.

ndet e ngjarjeve — me kalatë, grykat, malet etj., ku janë zhvilluar luftimet, gjakosjet me armikun etj. Arbëreshët, duke u shpërngulur nga atdheu, humbën bazën materiale të ekzistencës së legjendave. Mungesa e objekteve në ambientin e ri, ku ata u vendosën, duhet të ketë ndikuar edhe në zhdukjen e mundësisë së mbajtjes gjallë dhe të ripërtritjes së tyre.

Organet e para që botuan gojëdhëna për Skënderbenë nga vendi ynë qenë Kalendarit kombiar i vitit 1901¹¹ dhe sidomos revista Albania¹². Në këtë të fundit u dhanë vitet 1905-1906 16 gojëdhëna të mbledhura nga Shtjefën Gjeçovi (nën pseudonimin Lkeni i Hasit) në krahinën e Kurbinit dhe në Kthellë të Mirditës. Në një revistë tjetër, në Kopështin letrar, u përmbledhën më 1918-1919 gojëdhëna të krahinave të Elbasanit rreth Skënderbeut dhe Kralit të Sopotit, Gjorg Golemit¹³. Më 1926 u botua vëllimi Skandebërgu mbas gojëdhanash¹⁴. Në pjesën e parë të këtij vëllimi «Kallxime tradicionare» gojëdhënat janë dhënë, sipas një farë rendi kronologjik (a. Luftat e Sk. b. Udhëtimet e gjygjet e Sk. c. Vdeka e Sk. ç. Mergimi shqypetarvet). Disa prej tyre janë elemente origjinale të mbledhura në Kurbin të Krujës dhe në ndonjë fshat të Mirditës e të Matit; ndërsa pjesa tjetër janë përshtatje në prozë (në dialektin e veriut) të këngëve arbëreshe ose thjesht elemente historike të kallxuara në frymën popullore. Pjesa e dytë përmban këngë të ndryshme epike (të Skënderbeut, balada, këngë kreshnikësh etj.). Gojëdhëna për Skënderbenë u botuan gjithashtu në revistat Normalisti (1929)¹⁵, Edukata e re (1930)¹⁶, Hylli i Dritës (1931)¹⁷, Cirka (1939)¹⁸, Shkolla shqiptare (1940)¹⁹ dhe në Visaret e Kombit vëll. XIII (1944)²⁰ etj. Kësaj trashëgimie, që nuk i kalonte të 50 elementet, iu shtuan pas çlirimit rreth 1300 elemente të tjera me kërkimet sistematike dhe regjistrimet që u bënë në rreth 300 pika ndër krahina të ndryshme të vendit²¹. Disa prej këtyre materialeve janë botuar nëpër revista, anatologji shkollore dhe sidomos në vëllimin Këngë popullore historike²². Krahas botimit të vetë gojë-

11) L.K. *Kujtime kombëtare*, Kalendarit kombiar. Sofie 1901 f. 56 (3 gojëdhana nga fshatrat Bixullë, Preçë e Mollagjesh të Elbasanit).

12) Lkeni i Hasit. *Gjergj Kastrioti Skendërbegu* (Gojëdhanat e popullit t'Kurbinut e t'Kruës). Albania IX 1905, nr. 12 f. 226-227; X 1906 nr. 1 f. 6, nr. 2 f. 27-28, nr. 4 f. 62-64.

13) L.N. *Skënderbeu në liqen t'Ohrit*; në Rraicë, Griqan, Bixëlle, Kopështi letrar 1918 nr. 1 f. 15, 16; Sk. në Guste të bardhë nr. 2 f. 9; Sopotit nr. 4 f. 14-15; Lufta e Mëlizës 1919 nr. 6 f. 14.

14) M. Sirdani. *Skandebërgu mbas gojëdhanash*. Shkodër 1926.

15) H.R. *Skënderbeu në Bulqizë*; S. në Liqe të zi, Normalisti 1929.

16) *Gojëdhanat mbi gurin e Sk. që gjëndet në katundin Burrarë* (Tiranë). Edukata e re 1930, nr. 4 f. 159.

17) M. Sirdani. *Zemra e Skandërbegut* (Histori e legenda) Hylli i Dritës. Shkodër 1931, nr. 5 f. 291-299.

18) F.Gj. *Guri i Skandërbegut dhe mullini me erë*. Cirka 1936, nr. 4 f. 60-61.

19) M.Gj. Bushkashi. *Shkolla shqiptare* 1940.

20) *Visaret e Kombit vëll. XIII*. Tiranë 1944 f. 154, 173, 174.

21) Në këto kërkime mund të përmenden për rezultatet e tyre ekspeditat e punonjësve të Folklorit në: Malësi të Tiranës (1949); Krujë e Mat (1950); Pukë (1950 e 1956); Kukës, Tropojë, Lezhë e Shkodër (1952); Dibër e Mirditë (1953); Elbasan, Librazhd, Gramsh, Lum të Vlorës dhe në Bregun e detit (1954); Lurë (1957); Malsi e Shkodrës (1958, 1961), në Grykën e Zaranikës Elbasan (1959, 1966); Krujë e Mat 1967. Në ekspeditat e fundit materialet janë inçizuar edhe me manjetofon. Kontribut kanë dhënë në kërkimet e tyre dhe bashkëpunet e jashtëm të Institutit Dhimitër S. Shuteriqi, Dhosi Liperi dhe Hilmi Sadiku.

22) *Këngë popullore historike*. Tiranë 1956 f. 45-57.

dhënave, pas çlirimit, janë shkruar edhe një tog punimesh, në të cilat trajtohen probleme të përbajtjes të tyre²³. Është për t'u theksuar se materialet e mbledhura pas çlirimit janë regjistruar gjatë bisedës me njerëz që përfaqësojnë traditën e pastër popullore, dhe janë shoqëruar me të gjitha të dhënat e duhura të një dokumentacioni shkencor. Këto materiale që përfaqësojnë frytin e një pune kërkimore sistematike në të gjitha krahinat e vendit, nxjerrin në shesh plotësisht realitetin e kësaj tradite në kushtet e ekzistencës aktuale të saj — zonat e shtrirjes gjeografike, shkallën e dendësisë që karakterizojnë përhapjen e tyre në çdo krahinë, përbajtjen tematike etj.

Tradita popullore për Skënderbenë, e marrë në vështrim të gjerë — duke përfshirë në të gojëdhënat dhe kujtimet popullore që ruhen edhe për bashkëkohasit e heroit, objektet dhe vendet që njihen në popull me emrin e tij etj. — jeton në rrethin e Krujës, të Matit, të Dibërës, Kukësit, Mirditës, Pukës, Lezhës, Elbasanit, Librazhdit, Durrësit dhe në atë të Tiranës. Këto zona mund të quhen treva kryesore e kësaj tradite, treva në të cilën gojëdhënat për Skënderbenë dhe bashkëkohasit e tij paraqiten me një tërësi organike. Këtu gjenden kala e qyteza si Kalaja e Krujës, e Varoshit, e Gurit të bardhë, e Petrelës, e Shëngjinit, e Valikardhës, e Grazhdanit, Kalaja e Lezhës, e Sopotit etj. si edhe një varg vendesh (male, gurra, shkëmbinj, shpella) me emrin e heroit, që formojnë nyjet kryesore të kësaj tradite. Këtu janë zhvilluar, sikurse dihet nga letërsia historike, edhe ngjarjet më të rëndësishme të periudhës së Skënderbeut. Prandaj mund të thuhet se ekzistenca e traditës në këto zona është kushtëzuar në radhë të parë nga realiteti historik, nga ngjarjet që i kanë dhënë shkas lindjes dhe zhvillimit të gojëdhënave, të cilat nga ana e vet kanë shërbyer si pllaka të gëdhëndura lavdie, që nuk kanë lënë të mbulohet kujtimi i tyre nga terri i shekujve. Në procesin e zhvillimit dhe të ruajtjes së gojëdhënave të Skënderbeut në këto zona duhet të kenë luajtur rol edhe faktorë të tjerë si ekzistenca e një farë tradite përsa i përket lëvrimin të këtij lloj krijimi popullor, ambienti gjeografik (zona të tërhequra malore) etj.

Elemente të traditës së Skënderbeut gjenden edhe në rrethin e Shkodrës, të Tropojës, Gramshit, Korçës dhe në atë të Vlorës; jashtë kufinjve shtetërore — në krahinat shqiptare të Maqedonisë, të Kosovës dhe të Malit të Zi. Edhe këtu mund të mendohet se kemi të bëjmë me zona që dikur kjo traditë do të ketë pasur një zhvillim më të madh, por më vonë, nën ndikimin e faktorëve të ndryshëm, janë zbehur dhe rrëgjuar. Nga një anë tjetër, në ndonjë pikë të këtyre zonave të fundit mund të kemi edhe ndonjë përhapje të vonë ose të rastit.

Megjithqë elementet e njohura kushtëzohen nga numri i qendrave të eksploruara koha e kërkimeve etj., me shifrat që jepen më poshtë rreth elementeve të mbledhura në çdo zonë mund të formohet një ide rreth shkallës së përhapjes së kësaj tradite në krahinat e ndryshme të vendit: Dibër 594 elemente, Durrës 4, Elbasan 146, Gramsh 2, Korçë 1, Krujë 165, Kukës 37, Lezhë 9, Librazhd 32, Mat 267, Mirditë 13, Pukë 16, Shkodër 3, Tiranë 42, Tropojë 2, Vlorë 6; Dibër e madhe 6, Kosovë 2, Mali i Zi 1.

Populli gojëdhënat rreth Skënderbeut i quan thasha, kallxime, punë a fjalë të moçme të Skanderbegut, kur këto kanë një farë su-

23) *Historia e letërsisë shqipe* Vëll. I. Tiranë 1959, f. 60-62 etj.

bjekti (për këtë kategori do të përdoren këtu termat gojëdhëna, tregime, legjenda); ose i le pa i cilësuar me ndonjë emërtim, kur ka të bëjë me kujtime të karakterit thjesht historik a me tregime visesh që mbajnë emrin e heroit.

Në traditën popullore rreth Skënderbeut, siç kuptohet, përfshihen elemente të ndryshme: gojëdhëna në kuptimin e vërtetë të fjalës, kur flitet sidomos për forcën e jashtëzakonshme dhe gjestet e mrekullueshme të heroit; të dhëna me karakter informativ, kur bëhet fjalë për fakte të ndryshme historike; toponime me emrin e Skënderbeut dhe të bashkëkohësve të tij (shoqëruar ose jo me tekst lidhur me emrin e tyre) etj.

Vëmendjen e masave popullore e kanë tërhequr ngjarje e fakte nga më të ndryshmet. Me interes janë të dhënat rreth prejardhjes së Kastriotëve dhe vendlindjes së Skënderbeut. Kjo temë zgjerohet me gojëdhëna ku bëhet fjalë për forcën e jashtëzakonshme të Skënderbeut (gojëdhënat për lindjen e tij me fletë nën sqetull si dragojt, për paprekshmërinë nga armët etj.).

Një temë qendrore është idealizimi i figurës së heroit, i vetive fizike e morale dhe gjesteve të tij të mrekullueshme, i efektit të çuditshëm të forcës dhe të fjalës së tij. Këtu mund të thuhet se fantazia popullore është përpjekur për ta skalitur dhe evidencuar çdo veti të udhëheqësit me dashuri të madhe; në këtë temë kanë arritur të marrin nga ana e strukturës tratjën e plotë të legjendës shumë elemente të kësaj tradite.

Temë tjetër e rëndësishme është ajo e informacionit për kalatë, qytezat, kullat etj. Tradita gojore ka ruajtur të dhëna me vlerë për ndërtimet dhe rolin strategjik të këtij sistemi të dendur fortifikimesh, që shërbyen si kyce të qendresës heroike shqiptare.

Në një kapitull të veçantë mund të përmblihen gojëdhënat që flasin për zhvillimin e luftimeve, për strategjinë dhe taktikën e ndjekur nga Skënderbeu në sigurimin e fitores ndaj kundërshtarit. Me këtë kapitull mund të mblidhen edhe të dhënat rreth armëve — llojit të tyre, vendeve të përgatitjes etj.

Një kapitull i rëndësishëm është ai i tregimeve, ku spikat në mënyrë të veçantë patriotizmi popullor — tregimet për burimet ekonomike e morale, për lidhjet dhe mbështetjen e fuqishme që gjente në masat popullore Skënderbeu, për heroizmin, shpirtin luftarak dhe guximin me të cilin ato përballonin vështirësitë e luftës.

Me interes janë gjithashtu të dhënat që kanë lidhje me shtetin e Skënderbeut dhe qeverimin e tij — për kufinj të deri ku shtrihej pushteti i heroit, sipas traditës gojore, për forcat luftarake, normat legjislativë, ndërtimet etj.

Një kapitull të gjallë dhe të lidhur drejtpërdrejt me emrin e Skënderbeut e përbëjnë toponimet — malet, shkëmbinj të, krojet, gjurmat ndër gurë, shpellat etj., që njihen në popull me emrin e heroit. Kuadri i kohës zgjerohet me një tog gojëdhënash e kujtimesh që ruhen për bashkëluftëtarë të Skënderbeut. Ka midis tyre të dhëna që flasin për figura të njohura dhe të rëndësishme si p.sh. për Lekë Dukagjinin, Gjorg Golemin, Mojsinë dhe ndonjë tjetër; ka gjithashtu tregime që sjellin emra dhe gjeste njerëzish të thjeshtë, që nuk kanë lënë ndonjë emër në dokumentat historike, siç është rasti i figurës aq tërheqëse të gojëdhënave të Kurbinit — Kokë Malçit, i Petër Petroshtit të Shpatit, Gjob Bësarit, Kapidan Senës, Vidanit etj.

Në një kapitull të fundit përmbledhen gojëdhënat rreth vdekjes së Skënderbeut — tregimet për porositë e tij shokëve, që të mbajnë njëri tjetrin, për amanetin e armëve që i le tokës, për veshjen e popullit me xhoka të zeza si shprehje e një dhembje të thellë kombëtare etj.

Nga kjo paraqitje sado e shpejtë e përmbajtjes tematike të traditës gojore për figurën e Skënderbeut dhe kohën e tij, kuptohet se kjo gjini e rëndësishme e folklorit tonë ka lindur mbi një bazë historike të caktuar, si një pasqyrim artistik i një realiteti të madh të jetuar nga masat tona popullore. Në të kanë lënë jehonën e tyre pothuajse të gjitha ngjarjet e rëndësishme të kohës.

Karakterit realist i ngjarjeve, për të cilat bëhet fjalë në traditën gojore të Skënderbeut, lokalizimi i gojëdhënave dhe kujtimeve të popullit rreth vendeve ku shtjellohen ngjarjet, kushtet e lindjes dhe qëllimi i kësaj tradite, u kanë dhënë gojëdhënave tona një vulë origjinale. Në to nuk bëhet fjalë për mrekulli të tipit të legjendave hagiografike, që kanë për qëllim të lëvrojnë tek dëgjuesit bindjet për fuqinë e mbinatyrshme të personazheve të idealizuara nga letërsia fetare. nuk flitet për gurë me fuqi magjike të rrëmbyer nga mbretëri përrallore a mbyllje në shpella të nëndheshme, siç ndodh p.sh. me legjendat e Frederikut II, Kraleviq Markut etj. Tradita e gojëdhënave tona ka kushtet e veçanta të formimit të saj, strukturën dhe vetitë karakteristike, përmbajtjen dhe funksionin e vet shoqëror.

Duke u nisur nga ngjarjet e jetuara në një periudhë historike relativisht të vonë dhe duke u lokalizuar në një varg objektsh konkrete: kala, qyteza etj., ato nuk kanë arritur të fitojnë në përmbajtjen e tyre një shtjellim të gjerë fantastik. Këto rrethana të veçanta të krijimit dhe të ruajtjes së tyre u kanë dhënë legjendave tona një karakter realist, që i afron shpeshherë deri në llojin e një kujtimi popullor thjesht historik. Shumë prej tregimeve tona marrin karakterin e një informacioni: «Skënderbeu e ka pasë nejen në Varosh», «Lurasit kanë qanë kalorsit e Skanderbegut», «Madja i ka nimue me pushkë Skanderbegut e pranej i ka mbetë Madja e pashkelme». Ky karakter ruhet në përgjithësi edhe në vetë tregimet që paraqesin idealizime të vetive morale e fizike të heroit: «Kur ishte rrethue Skënderbeu në Kala të Shëngjinit, zgjaste dorën në Erzen e u epte uj ushtarve», «Kur del venerakeja në qiell, pleqt thonë se kjo a shpata e Skanderbegut» etj.

Gojëdhënat e Skënderbeut nuk kanë ndikime fetare, siç ndodh me legjendat e disa personazheve historike të popujve të tjerë. Rolandi lufton kundër saracenëve për mbrojtjen e krishterimit. Kraleviq Marku ndërton një varg kishash për të larë mëkatet e tij. Kurse në asnjë legjendë të Skënderbeut nuk bëhet fjalë për lufta që nisen nga ideale të tilla fetare, asnjë prej kishave që kanë qenë në vendin tonë nuk kanë mbajtur, sipas traditës popullore, emrin e tij.

Faktori themelor në njëzimin e legjendave tona, cimenti që i lidh ato, janë motivet e një patriotizmi të thellë masiv. Me një gjuhë sa të thjeshtë aq edhe të fuqishme e të skalitur, ato tërheqin vëmendjen për lufta të ashpra që zhvillohen kundër një armiku të egër e mizor. i cili shkatërron qendra e fshatra të lulëzuara si Varoshin e Matit, Shkretën e Krudës etj., për beteja në të cilat skuqen nga gjaku i luftëtarëve fusha e lugina, që morën emrin që prej asaj kohe **Fusha e Kuqe, Lqeri i Kuq**, etj.

Duke ruajtur lavdinë e luftërave që u zhvilluan në Vajkal e Kastriot, në Dejë a në Malin Skënderbeg, në grykat e Drinit, të Matit

a të lumit Shkumbin, këto tregime popullore na venë përpara madhërshtinë, forcën, virtytet dhe cilësitë luftarake të të parëve tanë, të cilët ditën të përballojnë për një çerek shekulli me një guxim dhe shpirt luftarak të jashtëzakonshëm sulmet e një armiku, që ish bërë tmerri i botës, duke mbrojtur pëllëmbë për pëllëmbë atdheun e vet dhe duke ndihmuar me luftën e tyre edhe për mbrojtjen e lirisë së popujve të tjerë të Ballkanit dhe të qytetërimit evropian.

Te Skënderbeu masat tona popullore vështruan «kapidanin e paretrembur, mjeshtërin e palodhur» të luftës së tyre kundër armiqve të huaj dhe kundër anarkisë feudale vendase. Prandaj ato e ndoqën me vendosmëri dhe u bënë një burim i pashterur forcash njerëzore, energjish e mjetesh për mbajtjen në këmbë të betejave, që u zhvilluan nën udhëheqjen e tij. «Me heroin tonë kombëtar në krye Gjergj Kastriotin — Skënderbeun, ka thënë shoku Enver, — populli ynë luftoi me heroizëm të shquar për një çerek shekulli. Ai kurdoherë delte fitonjës mbi hordhitë e imperatorisë otomane, pse ai luftonte për lirinë, për independencën, për tokën». 24

Luftat e ashpra dhe ngadhnjimtare, që u zhvilluan në këtë periudhë, zbuluan energjitë e mëdha të masave tona popullore, qëndresën e tyre legjendare, patriotizmin, dashurinë e thellë për atdheun, urrejtjen e pakufishme ndaj armikut. Nëpërmjet të këtyre luftimeve u dalluan edhe vetitë morale e luftarake të udhëheqësit. Ushtarët njohën aftësitë e strategut që manovronte në mënyrë të mrekullueshme përpara sulmeve dhe rrethimeve të armikut, guximin, vendosmërinë dhe befasinë e rrufeshme me të cilën ai godiste ushtritë turke, luftëtarin trim, që hidhej i pari aty ku ishte rreziku më i madh. Në kohë të qeta populli admiroi urtësinë e prijsit, që diji të frenojë rivalitetet feudale, të bashkojë për qëllimin e lartë të mbrojtjes së atdheut gjithë vendin, vullnetin e hekurt, aftësitë e tij organizative. Të gjitha këto lanë gjurma të thella në mendjen dhe zemrën e njerëzve dhe u bënë burim frymëzimi për krijimin e legjendave rreth jetës dhe veprimeve luftarake të tij. Në këto legjenda figura e Skënderbeut del me vetitë e një luftëtari energjik që e ndjek këmba-këmbës dhe s'e le asnjëherë të qetë armikun, që përgjaket në beteja të ashpra dhe të pareshtura me të.

Fantazia e gjallë popullore, e frymëzuar nga gjestet luftarake të udhëheqësit dhe fitoret e tij, e idealizoi me përpjesëtime gjigande forcën e krahut dhe të shpatës së Skënderbeut. Barleti thotë: «Trimëria e kryetërit u dukej të gjithëve e pamposhtur... pothuaj asnjë goditje nga dora e tij nuk shkonte kot» 25. Në të tilla rrethana shpata e heroit, në legjendat e Matit është krahasuar me madhësinë dhe flakërimën e ngjyrave të ylberit. Forca e saj e mrekullueshme është dhënë me legjendat e prerjes së shkëmbit që mban emrin e heroit në Varosh, («Skënderbeu, për me provue shpatën, i ra një shkami n'Varosh «fap» ene e preu dy copash»); me hapjen e shkallës së Rrajcës në Librazhd, («Shkallën e Rrajcës e ka hapë Skënderbeu me shpatë. Ushtritë turke po shkojin për Prenjas. Skënderbeu preu shkamin, hapi rrugën, i dul turqve përpara dhe i faroi»); me shpërthimin e ujrave të kroit të Altarit në Milot, të Gurrës së Trodhnës në malin e Bazjes etj. Duarte e Skënderbeut janë të hekurta. Në Gjytetin e Arrasit ai biron shkëmbin

24) E. Hoxha. *Raport në Kongresin e I-të të Partisë Komuniste të Shqipërisë*. Tiranë 1949, f. 5.

25) Barleti f. 340.

me dorë sikur t'ish i brumtë dhe lidh frenin e kalit të tij; lëviz shkëmbinj për të zënë ose hapur grykën e shpellave si në Pogjoj të Kuksit a të Lurës (Dibër). Në Malin Skënderbeg a në Konaj të Mirditës, në Besh të Tiranës a në Pishkash të Librazhdit Skënderbeu shtron tryeza të gurta cikloprike. Vgjollat që mbajnë emrin e heroit në Labinot të Elbasanit, janë hedhë prej tij nga maja e maleve të Jabllanicës, kur luante me shokët gurapeshas. Si një Herkul ai rrëzon nga malet e Bulqizës shkëmbinjtë që ndodhen midis Vajkalit e Valikardhës, për të asgjësuar armiqtë. Po me një forcë të tillë herkuliane ai shkep nga malet shkëmbinj dhe ja vërvit armiqtë që kanë rrethuar Kalanë e Kastriotit, ndal ujrat e Drinit dhe e mbyl vendin, që të mos kenë mundësi armiqtë t'i afrohen, etj.

Vëmendjen e atyre që i qëndruan gjithmonë pranë në zjarrin e betejave, nuk e tërheq vetëm forca e jashtëzakonshme e krahut dhe e shpatës së udhëheqësit, por edhe aftësia me të cilën ai dinte t'i shmangej rrezikut të goditjeve dhe sulmeve të kundërshtarit. «Të gjithë — shkruan Barleti — besonin e thonin se trupi i tij ishte hyjnor dhe i pacënueshëm, që s'i qasej as hekuri as ndonjë goditje tjetër njerëzore»²⁶. Paprekshmëria e heroit në gojëdhënat e popullit shpjegohet, sipas botkuptimit të kohës, me rrethanat e jashtëzakonshme të lindjes së tij. Barleti na ep legjendën sipas së cilës fëmia i ardhshëm paraqitej si një drangua i madh, që mbulonte me trup të vet Shqipërinë dhe kryet e shtrinte në kufi të turqve, ku përpinte armiqtë me gojë krejt të përgjakun si edhe atë të lindjes së heroit me një shpatë të shkruar në krahun e djathtë. Këtyre legjendave u bën jehonë në traditën e sotme një gojëdhënë e mbledhur në Macukull të Matit ku thuhet: «Skanderbegun s'e zente plumi, s'e pritte shpata, se ka pasë le, siç lejnë drangojt, me kmeshë e me fletë nan sjetull,²⁷ dhe një tjetër e mbledhur në Pllanë të Lezhës, ku Skënderbeu bëhet i paprekshëm, si Akili i vjetërsisë, nga lyerja e trupit të tij me barëra nga orët e malit.²⁸

Shprehje e admirimit të masave popullore për aftësitë e rralla të prijsit, i cili dinte të gjente sipas rastit taktikën më të përshtatshme për të siguruar fitoren, duke u tërhequr si në betejën e Torviollit a duke sulmuar me guxim në fushë të hapur si në Oranik e Pollog ose në shtigje malore si në Grykën e Vajkalit, për shpejtësinë e çuditshme me të cilën ai lëvizte me forcat e tij nga një vend në tjetrin; për goditjet e befasishme që i bënte armikut, për daljet e papritura nga rrethimet etj., janë gjithato tregime që flasin për fluturimet e Skënderbeut nga një kala, qytezë, mal a shpellë në tjetrën. «Skanderbegju — thohet në legjendat e mbledhura në Mat e Dibër, ka kce prej Gjurit t'Kuq e ka ra n'Qafë të Lurës»; «Skanderbegu ka ba të hofme prej Gjitezës Selishtës e në Varosh», «Kur shtërngonte lufta, Skanderbegju fjaronte nga Deja në Gur të bardhë e n'Bulqizë, prej kndej në malin e Bazjes, n'Darsi e në Krujë etj.» Lëvizjet dhe çfaqjet e papritura të heroit janë të lidhura edhe me aftësitë e çuditshme të shokut të tij të pandashëm: Skanderbegju ishte vetë kreshnik, po ene atin e kishte ç'i shkote hava²⁹ Cilësi të tilla të jashtëzakonshme të kalit e mushkës së tij, e gjejnë shprehjen e tyre në një varg gjurmash të ngulura si në

26) Barleti f. 340.

27) *Tregime dhe këngë popullore*. Tiranë 1967, II/2 nr. 3-5, f. 24.

28) *Po aty* II/2 nr. 6, f. 25.

29) *Po aty* IX/1 nr. 48, f. 123.

«borë» a në llaç «në rrasën e fshatit Zajç të Selitës, në Landë të Lurës, në Gjurin e Marke në Muhërr, në grykë të Urakës, në Çidhnë, Buzhiq, Derjan, Petrelë, Labinot etj., që njihen në popull me emrin **Gjurma të kalit a të mushkës së Skënderbeut.**

Në ndonjë gojëdhinë gërshetohen motive të një fondi të hershëm «**Skanderbegju, si maronte luftën, fluronte me kalë në shpella, se ishte luturâ, ishte si shpend, si orë.**» Në Çidhnë nuk e vrasin merimangën se ka zanë me pëlhurën e saj grykën e shpellës ku ish tërhequr Skënderbeu, duke u bërë shkak kështu për shpëtimin e tij nga ndjekjet e armiqve.

Në idealizimin epik të figurës së Skënderbeut mund të vihet re ndonjë element a skemë, që paraqet afri me ato të legjendave të popujve të tjerë. Shpata e Skënderbeut pret shkëmbin e Varoshit siç pret kudrën e hekurt shpata e Sigfridit, e Rolandit a e herojve të poemave epike të popujve të tjerë; paprekshmëria e tij magjike të kujton paprekshmërinë e Akilit, Sigfridit, Mujit, Kraleviq Markut, Sosrukos, Allpamishit. Edhe fluturimet e kalit vigan, ndihmës të heroit, paraqesin ndonjë situatë të afërt me ato të kuajve të poemave homerike, me Gjogun e Mujit, Sharanin e Kraleviq Markut, Bajardin e këngëve të gjesteve të popullit freng, Rakshën, Giratën etj. Por këto elemente të ngjajshme përfaqësojnë vetëm afëri tipologjike, që lidhen me kushte të caktuara të zhvillimit shoqëror e kultural. Nëpër këto tregime, ku mund të bëhet fjalë për ngjajshmëri qoftë me elemente të traditës së mëparshme vendase, qoftë me ato të popujve të tjerë, është derdhur jeta shqiptare, është fiksuar realiteti i një periudhe të caktuar historike të popullit tonë. Nuk mund të vihet asnjë farë lidhje e drejtpërdrejtë midis shkëmbinjve të rrëzuar nga Polifemi për t'u hakmarrë kundër anijes greke dhe shkëmbinjve që rrëzon Skënderbeu në Bulqizë për t'i prerë hovin ushtirisë turke. As mund të kërkohet një ndikim i tillë në tregimet e tjera ku idealizohet forca e heroit. Tradita jonë rreth Skënderbeut qëndron si një krijim i pavarur, si një pasqyrim i realitetit historik shqiptar, fryt i veprimtarisë së gjallë, i frymëzimit dhe aftësive krijuese të masave tona popullore. Skënderbeu zgjat krahun e tij vigan nga muret e një kalaje të caktuar, të kalasë së Shëngjinit, dhe merr ujë gjithashtu në një lum të caktuar, në Erzen. Mrekullitë e forcës së krahut dhe të shpatës së tij janë të lidhura me objekte, fenomene e toponime të tokës dhe të jetës shqiptare. Edhe në tregimet për urata e nëmë të Skënderbeut, ku mund të ndihet një farë ndikimi i ideologjisë fetare të pushtuesit, frymëzimi dhe përmbajtja e tregimit ka gjithmonë bazë historike. Në legjendat për rritjen e pyllit të Gjetës a të Mollagjeshit, për mjegullat e Bizës a murrarin e Likudës, për livadhet e Qafmurrës a liqenin e Pogradecit, apo për mbarëvajtjen e kësaj a asaj krahine, të këtij ose atij fisi nga efekti i fjalës së heroit, nuk bëhet fjalë për efekte të mrekullishme biblike, por për fiksimin e një kujtimi historik, që lidhet me jetën dhe veprimtarinë e Skënderbeut për rritjen e besimit në aftësitë udhëheqëse të tij, për forcimin gjithnjë e më shumë të ndjenjave të patriotizmit, të dashurisë për vendin, të shpirtit luftarak, të optimizmit dhe të perspektivës së masave popullore.

Fantazia e popullit vërtet e ka idealizuar figurën e Skënderbeut me ngjyra hiperbolike, por ajo nuk e ka mistifikuar, nuk e ka shkëputur asnjëherë atë nga ambienti i gjallë i jetës reale. Ky hero që ka aftësi të lëvizë shkëmbinjte, të mbajë ujrat e Drinit a të hidhet nga një

vargmal në tjetrin rron në mes të popullit, në mes të njerëzve të tij. Skënderbeu shkon ndër miq e shokë sipas zakoneve tradicionale të malësorëve, argëtohet me ta me biseda për ngjarje që tërheqin vëmendjen e tyre — për «kunguj» që s'u sosit vera, për «kuqa» që ngjijnë me bukë ushtarët e tij, për tenda gjigande, që mbajnë diellin nga Lezha në Skuraj, admiron zgjuarsinë e njerëzve të thjeshtë, siç ndodh me bisedat alegorike të Kokë Malçit, merr pjesë në hallet dhe nevojat e popullit, u përmbush dëshirat, u ndan grindje e mosmarrëveshje, u pajton gjaqe e gjygje si një «plak zakoni».

Po me një vijë të tillë realiste tradita popullore na ka ruajtur kujtime që hedhin dritë mbi sferën e forcës së pushtetit të tij shtetëror: «Shqipnia në kohë të Skënderbegjut ka qanë e madhe — merrte Shkup, Manastir, Ohër, Strugë, Dibër, Kosovë, Shkodër, Mat, Krujë e shkonte teqë deri matanë Xhinokastrën». Skënderbegju në Gur të Bardhë, Ketë, Koms, Bruç e Varosh ka pasë dingat e barutit; në Lurë, Muhërr e Shlli-farkat ku nreqte armët, aletet e luftës, pllakat prej hekuri që i vente dierve të kalave; në Selitë të Tiranës e në Muzhëllmademet e krypës; në Varosh, Valikardhë a te arkat e pareve në Selishtë ka pasë florinjte, që sipas legjendave, ruhen akoma dhe sot nga gjërpinj fantastikë. Përfund të kalasë së Gurit të Bardhë dhe në Livadhet e Skënerit në Klos, stërviteshin luftëtarët e tij. Skënderbeu ka pasë përpunuar nene të kanunit rreth gjakut, martesës etj. duke u udhëhequr nga qëllime e interesa të gjera të popullit, qëllime e interesa që sillnin si rezultat forcimin e bazës së tij shtetërore. Në Vig ka nxjerrë për vaditje një vijë ujë, që njihet edhe sot në popull me emrin **Vija e Skënderbeut**, në Qafë të Buellit ka çarë vendin për të larguar ujrat që mbytnin më parë Fushën e Bulqizës etj.

Elemente të tilla të ruajtura nëpërmjet të traditës përforcojnë të dhënat që na japin dokumentat e kohës rreth përpjekjeve të Skënderbeut për krijimin e një shteti të fortë e të qëndrueshëm.

Përpjekjet e tij për krijimin e një shteti të centralizuar «për bashkimin e kombit nën një flamur të vetëm» ngjallën armiqësi të ndryshme nga ana e feudalëve. Jehonën e këtyre armiqësive e sjellin në mënyrën e tyre edhe legjendat. Është për t'u shënuar fakti se sa herë që bëhet fjalë për Lekë Dukagjinin, sa herë që lidhet emri i tij me atë të Skënderbeut në traditën popullore, del ndonjë divergjencë, del ndonjë dredhi në drejtim të heroit. Leka shtyn me dinakëri kufinjte e pronave të veta në Mat në dëm të shteti të Skënderbeut; ai ve malësorët të bëjnë be, po me dredhi, për vërtetësinë e këtyre kufinjve duke u vënë nën këmbë dheun të marrë nga pronat e veta. Qëndrimi i tij shkon deri atje sa në një legjendë të mbledhur në Mat thuhet se «Mbreti i Stambollës i bediti në shpinë Skënderbeut Lekë Dukagjinin». Të tërheq vëmendjen fakti se këto legjenda tregohen në ato vise ku puqeshin zotërimet e të dy palëve, në zonat veriore të Matit e të Dibrës dhe në ato jugore të Lumës e të Mirditës.

Këtyre vështirësive dhe pengesave që gjente Skënderbeu në rruqën e përpjekjeve të tij për krijimin e një shteti të centralizuar, është për t'i shtuar edhe përpjekjet e armikut që s'linte gur pa lozur, për të shfrytëzuar rivalitetet feudale, për të mbjellë përçarjen midis forcave luftarake shqiptare. Rasteve të Mojsiut, të Hamzës e të tjerëve, për të cilët flasin dokumentat e kohës, tradita popullore u shton edhe emra të tjerë komandantësh, oficerësh e shokësh të Skënderbeut si Berishajt, Marçent, Lalajt, Pacin, që ndihmojnë armikun për ndjekjen

e Skënderbeut, kur tërhiqet nëpër pyjet e Dibrës, apo i zbulojnë të fshehtat e pikat strategjike për marrjen e kalave si të asaj të Varoshit, të Çidhnës, Xhaxhishtit etj.

Përkrah kujtimin të këtyre fakteve të hidhura të historisë sonë të kaluar, tradita na ka ruajtur legjenda me një forcë të madhe emocionale ku tregohen shembuj solidariteti të masave popullore me heronë. «Ne do të ndjekim me gjithë zemër kudo që të na shpijesh, i thonin ushtarët udhëheqësit të tyre. Me ty e lehtë do të jetë për ne dëbora, i butë dimri dhe e ëmbël fort gjithçka. As vështirësitë, as ndonjë lloj rreziku s'ka për të na rënduar nën udhëheqjen tënde». ³⁰

Një unitet i tillë e kish burimin te drejtësia e luftrave që udhëhiqte Skënderbeu, te qëllimi i lartë i mbrojtjes së atdheut e lirisë, te çlirimi i masave fshatare jo vetëm nga «tirani i huaj, por edhe nga tiranët e vegjël të vendit, që i thëthitnin gjakun dhe i bënin të vriteshin vëlla me vëlla për interesat e tyre vetiake». ³¹ Prandaj, masat popullore e ndoqën me besnikëri prijsin dhe u bënë një rezervë e pashterur e potencialit të tij ekonomik dhe luftarak.

Legjenda, me gjithë thjeshtësinë e saj, sjell një aspekt të madh të këtij realiteti. Kur kalon çaste të vështira Skënderbeu në Varosh, lurasit futen përmes zjarrit të luftës, të shndërruar në farkaxhinj e qymyrxhinj, me kuaj kinse të ngarkuar me qymyr, për t'i sjellë heroit ushqime dhe armë, me të cilat munda të çajë rrethimin dhe të asgjësojë armikun. Banorët e fshatrave të Tomadhesë, kur rrethohet Skënderbeu në Kalanë e Shëngjinit, sulmojnë turqit nga shpina, duke përdorur mjete, që janë legjendarizuar nga fantazia popullore. Në rrethana të vështira banorët e Matit, i japin zemër duke i ushqyer mushkën me grurë, për t'i treguar se kishin kaq shumë burime ekonomike sa të mbanin edhe kuajt me drithë; barinjët e Shtjefnit të Matit, të Shëngjergjit etj. e ndihmojnë në këto çaste të vështira me prodhimet e tyre të veçanta blegorale.

Patriotizmi i masave popullore ndihet edhe në tregimet që flasin për vendosmërinë dhe qëndrimin e papërkulur të njerëzve të thjeshtë të popullit përpara mizorive dhe masave çnjerëzore të turqve «Fatiu i grini me kalamaç e me gra, por populli qëndroi se qëndroi». «Uji i Bardhë i Gjonmit është qumshti që rrjedh nga gjinjët e një nusje të futur të gjallë në dhe, sepse nuk i tregoi të huajit vendin ku ishin fshehur shqiptarët. Të nëntëdhjetë vajzat krutane hidhen nga Shkëmbi i Vajës në Prrua të Drosë, për të mos rënë në dorë të armikut».

Edhe në gojëdhënat që bëjnë fjalë për urata e nëmë të heroit, shihen gjithashtu lidhjet e tij të ngushta në kohë manovrimesh luftash etj. me masat fshatare, tek të cilat ai kish të vetmet mbështetje e burime të qëndrësës së tij heroike. Tregimet popullore nuk e fshehin të vërtetën. Pat fshatra e fise që nuk mundën të rezistojnë përpara kësaj prove të madhe, që rëndoi mbi shpatullat e popullit tonë. Tradita gojore nuk e ka shuar kujtimin e tyre të hidhur. Por ajo ka ditur të fiksojë me ngjyra emocionale sidomos rastet, kur masat tona popullore nuk kursejnë asgjë për fitoren e përbashkët. Për këtë dëshmojnë një tog tregimesh si ajo e plakut Gjob Bësarit, i cili, mbasi i vriten të shtatë djemtë nëpër lufta dhe i mbetet shtëpia në fëmijë e në gra, rend vetë për të marrë pjesë e për të qëndruar sa «ku të muj» në radhët

30) Barleti f. 297.

31) Fan S. Noli. Historia e Skënderbeut kryezotit të Arbërisë. Tiranë 1962 f. 87.

e ushtrisë së Skënderbeut, legjendat që bëjnë fjalë për pritjet e përcjelljet në Shëngjergj, Bixëlle, Labinot etj., për ndihmat që i janë dhënë heroit nga banorët e fshatrave të Matit, Dibrës, Mirditës, Tiranës, Elbasanit etj.

Në traditën popullore kanë lënë jehonën e tyre edhe figura të tjera, që dalin në marrëdhënje të drejtpërdrejta a të tërthorta me Skënderbenë.

Kështu janë ruajtur tregime me interes për figurën e Gjorg Golemit, që është identifikuar si vjehri i Skënderbeut, Gjergj Arianiti. Në këto tregime jepet me një forcë të veçantë sidomos ashpërsia e luftimeve dhe qëndresa burrërore e këtij luftari të pamposhtur që përballoi me guxim për njëzet vjet sulmet e egra të ushtrive të sulltanit. Armi-ku nuk mundi të futet në kryeqendrën e tij, në Sopot, veçse me tradhëti. Dhe në këtë rast shkëlqeu qëndresa e grave sopotare, të cilat tradita popullore i ka idealizuar me tipare fantastike. Toponimet si Guri i Gjorg Golemit, Gjurma dhe Qafa e kalit të Gjergjit, Lqeri i Kuq etj.; tregimet për marrëdhëniet e Sopotit me krahinat rreth e rrotull si me Polisin, Bërzesh të, Fushën e Prrrenjasit, Shpatin etj. flasin për një vatër të rëndësishme rezistence, e cila përkon me atë që thonë dokumentat historike për qëndresën e Gjergj Arianitit.

Në Shpat të Elbasanit rron legjenda e Petro Petroshtit a Petro Kapidanit, udhëheqësit të shpatarakëve, sipas gojëdhënave, në luftën e zhvilluar kundër Sulltan Mehmetit të dytë në Grykat e Shkumbinit (Mëlizë e Shushicë).

Tregimet e rrethit të Kukësit, të Tropojës, të Pukës, të Mirditës e të Shkodrës kanë si figurë qendrore Lekë Dukagjinin. Në zonat midis zotërimeve të tij dhe atyre të Kastriotëve, tradita e ve Lekën, sikurse është përmendur, në marrëdhënje dhe bashkëveprim me Skënderbenë, ndërsa në zonat më në veri flitet vetëm për Dukagjinët. Në këto zona të fundit gjenden kala e qyteza të lidhura me emrin e Lekës si Kalaja e Surrojt, e Malit të Zi, e Vaspasit, e Bunjanit, e Blinishtit; toponimet si Sofra a Tryeza e Lekës, Guri a Kepi i Lekës, Barka e Lekës etj. Përhapja e këtyre toponimeve në një trevë që shkon nga Shkodra deri në Kosovë, nga rrethi i Tropojës deri në atë të Matit e të Dibrës, dëshmon për kufinj të gjerë të zotërimeve të Dukagjinëve. Përkrah normave të së drejtës kanunore që njihen me emrin e Lekë Dukagjinit, tradita ka ruajtur edhe elemente të tjera, që hedhin dritë mbi pushtetin e këtij princi të fuqishëm e energjik.

Të njohura janë në zonën jugore të Peshkopisë tregimet për Mojsi Golemin. Në tregimet popullore rreth kësaj figure që është skalitur me të gjitha hijedritat e veta nga Barleti, jepen pak elemente. Flitet për lindjen e tij në fshatra të Dibrës, sipas varianteve — në Shupenzë, Bulqizë a Topojan; për qendrën që ka pasur në Kala të Grazhdanit dhe për ndonjë luftë të tij në rrethet e kësaj kalaje.

Gojëdhanat e mbledhura në Kurbin e gërshetojnë emrin e Skënderbeut me Kokë Malçin, një figurë që simbolizon, sikurse është zënë në gojë edhe më sipër, përvojën, zgjuarsinë dhe mënjërinë popullore.

Gojëdhana të tjera bëjnë fjalë për personazhe që njihen në një sferë të ngushtë si p.sh. për Gjokën e Memenë, të cilët kanë trashëguar, sipas traditës, «alametet» a dokumentat e heroit, pas prishjes së tij në Varosh; për Vidanin, Senën, Gjob Bësarin etj.

Të tilla tregime që e zgjerojnë kuadrin e personazheve dhe të ngjarjeve të periudhës së Skënderbeut, të tërheqin vëmendjen për ngulitjen dhe ekzistencën e tyre në ambiente të caktuara. Gojëdhanat

e Gjorg Golemit nuk e kalojnë krahun e djathtë të Shkumbinit, të Lekës, nuk zbresin nën zonat veriore të Matit e Dibrës, të Petër Petroshtit njihen në krahinën e Shpatit, të Kokë Malçit në Kurbin, ndërsa të Gjokës e Memeut në fshatrat rreth Varoshit. Këta kufinj të caktuar të shtrirjes së tregimeve flasin për karakterin realist dhe bazën historike të traditës popullore. Gojëdhëna a tregimi popullor nuk lind rastësisht, por e merr pikënisjen, zhvillohet dhe jeton aty ku ka lënë jehonën e tij fakti historik.

Karakterit realist i tregimeve popullore të Skënderbeut kuptohet edhe më mirë nga gjithë ajo pasuri të dhënash që është ruajtur për rreth kalave e qytezave, që lidhen me emrin dhe veprimtarinë luftarake të heroit. Të tilla të dhëna ndihmojnë për të vërtetuar atë që na kanë lënë autorët e vjetër si Barleti etj. mbi këto nyje të rëndësishme të qëndresës shqiptare, sjellin elemente të reja për rolin e tyre, japin shpeshherë njoftime me shumë interes për identifikime faktesh e ngjarjesh që kanë mbetur të panjohura për letërsinë tonë historike.

Tregimet që ruhen nga tradita popullore për Krujën, i bëjnë jehonë madhësisë së kryeqendrës së rezistencës, kësaj vatre të pushuar të flakës së lirisë, që njohu në muret e saj ashpërsinë e luftrave më të përgjakshme të kohës. Populli flet për gjerësinë e qytetit që shtrihej sipas legjendës, nga Picrraga deri në Barkanesh, për muret dhe forcimet e kalasë me topa që rrihnin deri brigjet e detit, për jetën e brendëshme të saj (shtëpitë, tabiet, depot, banjot, pusët, burgjet); për dy rrugët kryesore që ndiqte armiku në sulmet kundër qytetit: midis krastave, nga Kroi i Fokës dhe nëpër Drojë nga Mulliri i Bojës; për ngritjen e topave nga sulltan Murati në Kryshkozë dhe në Shpërdhëtë; për vrasjen e Ballabanit në lagjen Abazej, pranë kroit që njihet me emrin e tij Ballabanec. Në traditën popullore ruhen kujtime për komandantët që mbronin kalanë, për luftën e pavarësisë dhe sidomos për zhvillimin e luftës në Zidoll, ku Skënderbeu i la armiqtë të afrohen deri tek porta e fshehtë e Kalasë dhe pastaj, si i preu rrugën pas shpine, u ra pa prituri dhe i griu; për rëndësinë strategjike që kish Kalaja e Zgërdheshit, për veshjen e ushtarëve me lëkura dhije nëpër luftime etj.

Të dhëna me interes ruhen për kalanë e Gurit të Bardhë (Mat). Midis tyre të tërheqin vëmendjen të dhënat për punishtet e barutit, stërvitjet dhe lodrat ushtarake, plagosjen e Skënderbeut, lidhjen e së shoqes së heroit me gratë e Gurit të Bardhë etj.

Në krahinën e Matit, përveç kalasë së Gurit të Bardhë, ka pasë gjurma kalash edhe në mal të Darsit, në Bruç etj., por mbreti i kalave të kësaj krahine, sipas traditës, ka qenë Varoshi që njihet në popull me emrin Varoshi, Qyteti a Kalaja e Skënderbeut. Vetminë dhe heshtjen që zotëron sot mbi mbeturinat e kësaj kështjelle, e thyejnë një sërë gojëdhanash që tregojnë se dikur në këtë luginë të bukur, e cila lidh Matin me Dibrën në një anë dhe Matin me Lurën në tjetrën, ka qenë një qendër e madhe banimi me një jetë ekonomike të lulëzuar dhe veprimtari luftarake të gjerë. Për këtë flasin gojëdhënat e pleqve të Varoshit, që ishin bërë nga 100 vjeç dhe nuk e kishin parë ndonjëherë njeritjetrin për shkak të gjerësisë së qytetit; flasin toponimet si Pazari i Varoshit, Arnajat, Farkat, Vijat. Kalaja e Skënderbeut, gojëdhënat rreth luftimeve dhe tradhëtive që bëhen për futjen në dorë të kësaj qendre strategjike të Skënderbeut etj.

Në Shëngjin të Tiranës, mbi lumin Erzen, gjenden mbeturinat e

një kështjelle që njihet nga fshatrat e afërm me emrin **Kalaja e Skënderbeut**. Dokumentat historike nuk e përmendin këtë kala, por populli tregon lloj lloj gojëdhënash për luftimet që janë zhvilluar në muret e saj midis Skënderbeut e turqve, për ndihmat që i kanë dhënë banorët e kësaj krahine Skënderbeut, në çarjen e rrethimit dhe asgjësimit e forcave të kundërshtarit në malin e Perrektosit. Edhe legjendat e pasura që rrojnë nga një anë, në katunde që gjenden midis kësaj kalaje e Krujës — legjendat e marrëdhënjeve dhe të komunikimit me anë zjarresh e kumbonash të Shëngjergjit me Krujën, të fshatrave Selitë, Besh e Bastar — si edhe legjendat, që jetojnë në fshatra midis saj e Grykës së Zaranikës, dëshmojnë për një vazhdimësi tradite që kushtëzohet nga faktorë të rëndësishëm historikë.

Vatra të gjalla të traditës gojore të Skënderbeut në Dibër janë mbeturinat e kalave, të gjytezave dhe të viseve të tjera të fortifikuara si **Kalaja a Gjiteza e Çidhnës, Cuculi, Kalaja e Grazhdanit, e Kastriotit e Kojovecit. Xhiteti në Lurë, Meçadi, Orveniku, Peladhia, Valikardha**; jashtë kufinjve të sotëm shtetërorë **Koxhaxhiku e Modriçi**.

Toponimet dhe gojëdhënat që jetojnë në veriperëndim të Peshkopisë në të dy anët e Drinit, në Lurë, Çidhnë, Sinjë, Kastriot flasin për një trevë të rëndësishme të shtetit të Skënderbeut, e cila gjen mbështetje tek ato që thotë Gjon Muzaka për plengun e parë të zotërimeve të Kastriotëve si edhe tek përpjekjet e armikut për asgjësimit e qëndresës shqiptare, duke iu futur vendit nga veriu (nga Kosova).

Në Kastriot ka pasë, sipas legjendës, 5000 shtëpi «gjitmas, sa shkonte maca kulm më kulm e pajte uj në Dri». Ktu ka pasë **Xhitetin e nejes Skanderbegju**. Në derën e kalasë është **Gjuri i luftës së Skënderbegjut**, më tutje **Terzishta, Bunari, Kroj, Fusha, Kshtejat e Kastriotit**. Në Kala të Volës, të cilën Skënderbeu e përdorte për mbrojtjen e kësaj qendre të madhe të banuar, vinte «tamli» me lugje nga bjeshkët. Qëndresa e zakonshme e ushtrisë së Skënderbeut ishte në krahun e përtejme të Drinit, në zonën malore të Xhaxhishtit: Vetë heroi rrinte në Xhaxhanj, i rrethuar prej oficerësh besnikë si Biba, Vidani etj. që lëftojnë deri në vdekje pranë tij, por edhe prej njerëzish si Marçeni, Berisha, Vladi, që i zbulojnë armikut të fshehtat me anën e të cilave ai fut në dorë me dinakëri këto kështjella që s'është i zoti t'i marrë me luftë burrërore ballë për ballë kundërshtarit.

Në jug të Peshkopisë vlen të përmendet **Valikardha**, një kala me pozitë kyç për fushën e Bulqizës dhe krahinën e Matit në përgjithësi, ku tradita popullore ka ruajtur një tog kujtimesh që hedhin dritë mbi ngjarjet e zhvilluara në këto anë.

Kalaja e Valikardhës ka «hem llagëme që merrshin ujë në lum, hem llagëme që delshin në Librazhd të Elbasanit». Këtu Skënderbeu ka ardhur me luftë dhe ka zënë vend në **Qafë të Kullës, në Xhitet**. Kur e rrethojnë turqit dhe deshën ta marrin, duke i prerë rrugët e furnizimit, ky gremis nga muret e kalasë mushkën e ushqyer me grurë dhe e çorienton armikun. Para Valikardhës qëndrojnë si poste të avancuara nga lindja Kalaja e Krajkës, e ndërtuar mbi një majë shkëmbore

strategjike dhe Kalaja e Peladhisë, kurse nga perëndimi i saj në fushë të Bulqizës gjenden **Gurët e Skënderbeut**, Fusha e Vajkalit etj.³²

Një tjetër kala e rëndësishme e pjesës jugore të Dibrës është ajo e Grazhdanit pranë fshatit Kërçisht. Fantazia popullore ka krijuar këtu legjenda për dyer që «u xhexheshte xhëmajmi» deri në Strugë, për thesare të ndryshme nëpër kasa të gurta, për rrjedhjen e qumshtit, si në Kalanë e Volajt, me lugje nga stanet e Malit të Shëmrisë dhe për motive të tjera që i përkasin një fondi karakteristik përralle. Por këtu ruhen edhe kujtime që lidhen drejtpërsëdrejti me periudhën e Skënderbeut, siç janë ato që flasin për zotërimin e Mojsi Golemit, për luftat që zhvillohen në muret e saj midis Skënderbeut e turqve, për pushtimin, më së fundi të kësaj kalaje, me anë kurthesh e dinakërish që të kujtojnë taktikën e përdorur nga turqit, sipas Barletit, për marrjen e Sfetigradit.

Gojëdhëna pak a shumë të afërta tregohen edhe për mbeturinat e një kalaje që ndodhet përtej kufinjve, për Koxhaxhikun. Duke u mbështetur në të dhënat gjeografike që jep Barleti për kalanë e Sfetigradit, të cilën e quan «mbretin e kalave të Dibrës», në emrin Koxhaxhik që është shpjeguar si me prejardhje nga fjalët turke **koxha xhenk: luftë e madhe**, si edhe në legjendat që rrojnë në popull mbi këtë kala, ka pasur mendime për lokalizimin e Sfetigradit në rrenojet e Koxhaxhikut. Sidoqoftë nga të dhënat e përmendura të letërsisë historike dhe të traditës, Sfetigradi nuk mund të kërkohet jashtë këtyre dy qendrave — Kalasë së Grazhdanit dhe asaj të Koxhaxhikut.

Tradita popullore ruan të dhëna gjithashtu për Kalanë e Modiriçit-Modrisën që e ndërtoi Skënderbeu më 1451, kur humbi Sfetigradin, si edhe për disa rrëtime kalash e qytezash, që shtrihen nga Homeshi deri në Zabzun.

Po të bëjmë një paraqitje kartografike të gjithë këtyre gojëdhënavave e kujtimeve, që na ka ruajtur tradita popullore për periudhën e Skënderbeut, do të shohim se ato shtrihen në zona, në rrugë dhe drejtime të caktuara, që tërheqin vëmendjen për ko incidencën e tyre me faktet historike. Legjendat e rrethit të Krujës — për Kalanë, për Fushën e Kuqe në Alk të Gurrzit, për Ujin e Bardhë, për Krojin e Altarit në Milot etj. — nuk mund të shkëputen nga ngjarjet e zhvilluara në këto vise, nga rrethimet e njohura të Krujës, luftimet në Fushë të Kuqe (Rubra), në Albulenë etj., për të cilat bën fjalë Barleti dhe dokumentat e tjera të kohës.

Në krahinën e Matit gojëdhënat e Skënderbeut rrojnë në fshatra të malit strategjik që mban emrin e heroit, Malin Skanderbe, i cili ndodhet midis kësaj krahine dhe Krujës. Gojëdhënat që jetojnë në fshatrat rrëzë tij — Pëshkash, Bazje e Karicë, i përgjigjen rrolit që duhet të ketë lozur ky mal si limer i forcave të Skënderbeut qoftë për veprimet luftarake në Mat, qoftë si mbështetje e ngjarjeve të Krujës. Qendra e

32) Valikardha nuk përmendet nga Barleti, por të dhënat e traditës, që e paraqesin këtë qendër si një vatër të gjallë legjendash, gjejnë mbështetje në dritën e dokumentave të reja. Prej këndej komandanti venedikas Antonio da Kozenca i shkruan më 17.IX.1464 dukës Kristofor Mora një akt të rëndësishëm ku flitet mbi inkursionet që bënte Skënderbeu për pajisjen e ushtrisë së tij me armë e ushqime; për zbuluesit që vinte heroi në gjurmimin e lëvizjeve të ushtrive armike etj. Nga ky dokument kuptohet se Valikardha (Valle Carda) ish në këtë kohë një qendër e banuar jo vetëm prej trupave shqiptare, por edhe prej forcave të tjera të ardhura nga jashtë (Krs. Francis Pall. *I rapporti italo-albanesi intorno alla metà del secolo XV*. Napoli, 1966, f. 202-204).

krahinës së Matit mund të quhet si zonë e bardhë përsa i përket përhapjes së këtyre gojëdhënave, por në krahun e saj verior dhe në atë të jugut tregimet popullore për Skënderbenë zgjaten si dy kordonë të pakëputur: a) nga veriu — nëpër Laç, Urakë, Pirell, Rremull, Derjan, Shtjefën, Macukull, Shlli e Varosh, Vinjoll; dhe b) nga jugu — nëpër Kala të Darsit, Fshat, Gurë të Bardhë, Val, Gjon e Peshk të Martaneshit. Nga nyja shumë e rëndësishme veriore e kalasë së Varoshit këto gojëdhëna futen në Dibër në dy drejtime: a) nga lindja nëpër Qafmurrë, Lukan, Selishtë, Arapaj e Muhur dhe b) nga veriu nëpër grykat e Lurës, në Çidhnë, Sinjë, Arras, Kastriot, Lashkizë. Prej këndeje ato vazhdojnë në Arrn, Bisakë e Konaj të rrethit të Kukësit, nga ku ndjekin në zonat e veriut gojëdhanat e Lekë Dukagjinit (Vilë, Kolesjan, Bicaj, Surroj etj.). Itinerari i krahut jugor të Matit kalon në Dibër nëpër fushën e Bulqizës — Vajkal, Koçaj, Dushë e Valikardhë del në Peladhi, Zerqan, Krajkë, Vlashaj e arrin deri në Shupenzë. Këtu bëhet një bigëzim i tij, në një anë nga veriu, duke përshkuar nëpër Homesh, Topojan, në Kala të Grazhdanit e të Koxhaxhikut dhe në tjetrën nga krahu jugor nëpër Kojovec, Orvenik, Ostren, Sebisht, Zabzun për të përfunduar në luginën e Çermenikës (Kostenjë, Neshtë, Gurakuq, Lunik, në luginën e Prevallit) dhe nëpërmjet të saj deri në lumin Shkumbin.

Një tjetër itinerar i këtyre legjendave nis nga Kruja, futet në rrethin e Tiranës nëpër malësi të Benës — me Bastarin, Beshin, Selitën; kalon në Tomadhe nëpër Shëngjergj, Shëmri, Façesh, Shëngjin, Fag e Killojkë dhe kapërcen në rrethin e Elbasanit, ku ndjek grykën e Zaranikës nëpër fshatrat Mollagjesh, Cërujë, Preçë, Guri i Zi, Labinot, Prapanik, Griqan, Bixëlle, Kozan, Baltëz. Në Elbasan e Librazhd legjenda e Skënderbeut puqet me atë të Gjorg Golemit. Duke ruajtur sejcila terrenin e vet — e Skënderbeut krahun e djathtë të Shkumbinit, e Gjorg Golemit të mëngjërën, ato vazhdojnë nëpër grykën e këtij lumi në Mëlizë, Shushicë, Polis, Mirakë, Babje, Qukës, Pishkash, Bërzesh të dhe arrijnë në skajin lindor përsëri deri në Rajcë.

Ç'tregojnë këto fusha dhe drejtime të përhapjes së gojëdhënave popullore të Skënderbeut? Dihet se në folklorin tonë epik kanë lënë jehonën e tyre kryesisht ngjarjet dhe veprimet luftarake. Këngët tonë historike sjellin në përgjithësi oshëtimin e lavdisë së korrur fytyrë me armikun nëpër fushat e betejës. Edhe tregimet për periudhën e Skënderbeut këndeje e kanë marrë frymëzimin dhe thurjen e tyre. Si dëshmi e jehonës së të tilla ngjarjeve, ekzistenca dhe drejtimit e përhapjes së tregimeve popullore na thonë se në këto itinerare duhet të kërkojmë edhe rrugët e ndeshjeve të mëdha të forcave tona luftarake me ato të pushtesve turq. Gojëdhënat e njohura paraqesin si pikë më të skajshme për këto veprime në zonat lindore Ohrit. Këtu nisnin, sipas traditës, edhe kontaktet më të largëta nga ana e lindjes e forcave shqiptare me ushtritë osmane. Të dhënat për Modriçin, Koxhaxhikun e Dibërën në njërin anë, ato të Zabzunit, Sebishtit, Steblevës, Kojovecit, si bazë e trupave tona, në anën tjetër, tregojnë drejtimin që merrnin trupat e armikut nëpër Grykën e Drinit. Gojëdhënat e Zerqanit, të Bulqizës dhe të krahut jugor të Matit flasin për njërin rrugë të ndjekur prej tyre në përpjekjet për asgjësimin e rezistencës shqiptare dhe pushtimin e Krujës nga lindja; ato të Kastriotit, të Çidhnës, Muhrit, Selishtës, Qafmurrës, Varoshit dhe të krahut verior të Matit paraqesin një itinerar të dytë për arritjen e këtij qëllimi; gojëdhënat e Lurës, me vazhdimin e tyre në Fan të Mirditës dhe në fsha-

tra të tjera të rrethit të Kukësit, tërheqin vëmendjen për një itinerar tjetër që varej nga veriu — nga Prizreni e Kosova; ndërsa gojëdhënat e pasura të Rrajcës, Fushës së Prrenjasit dhe të luginës së Shkumbinit, me ashpërsinë e luftimeve që janë zhvilluar për asgjësimin e Sopotit, me të dhënat që sjellin për rreptësinë e luftës së Mëlizës etj., dëshmojnë se pushtuesit turq kanë shfrytëzuar si një itinerar të rëndësishëm për invazionet në Shqipëri rrugën Ohër-Qafëthanë-Shkumbin, e cila përkon me itinerarin e rrugës së vjetër Egnacia, që Osmanët ishin përpjekur ta shfrytëzonin edhe lidhur me qëllimin e tyre për daljen në Itali.

Po të krahasojmë këto drejtime të përhapjes së tregimeve popullore me rrugët e invazioneve turke, që janë përshkruar nga studjuesit në mbështetje të Barletit dhe të dokumentave të tjera historike, do të vëmë re mjaft afëri midis tyre. Ky fakt flet në një mënyrë bindëse për bazën historike të traditës sonë popullore, për burimin e saj nga ngjarjet e jetuara.

Këtu mund të ngrihet si një problem i diskutueshëm çështja e ndikimit të letërsisë historike në frymëzimin dhe krijimin e gojëdhënave goftë nëpërmjet njohjes së drejtpërdrejtë të kësaj letërsie, goftë nga një njohje e tërthortë. Por një ndikim i tillë s'kish mundësi të ndodhte, se burimi kryesor, që mund të luante një rol të tillë «Historia e Barletit», ashtu si edhe dokumentat e tjera, kanë qenë të shkruara latinisht ose në gjuhë që nuk kishin se si të shfrytëzoheshin nga masat popullore. Edhe mundësia e ndonjë ndikimi të tërthortë si p.sh. nëpërmjet të klerikëve, që njihnin latinishten, nuk mund të jetë e pranueshme, se në këtë rast gojëdhënat duhet të jetonin më tepër në zonat e veprimt të klerit katolik, ndërsa ato i gjejmë, sikurse është thënë, në zona ku përhapja e tyre kushtëzohet nga faktorë të tjerë. Mundësinë e një ndikimi të tillë e përjashton sidomos vija e vecantë e pasqyrimt të ngjarjeve dhe fakteve historike nga njëri dhe tjetri burim. Si dëshmitë historike ashtu edhe tradita gojore bëjnë fjalë p.sh. për madhësitinë e qyteteve, të kalave dhe të ngjarjeve të zhvilluara rreth tyre. Por, ndërsa të parat, këto njoftime i japin me gjuhën e fakteve, tradita i idealizon me ngjyrat emocionuese të legjendës (krs. madhësitinë e Stellushit, që përshkruan Barleti me gojëdhënat e pleqve të Varoshit; rrethimet e Krujës dhe luftimet e Sopotit me gojëdhënat e Zidollit dhe ato rreth prejardhjes së emrave Shkretë, Fushë e Kuqe, Lqeri i Kuq). Në Gur të Bardhë, shkruan Barleti, gruaja e Skënderbeut kalonte verën midis vajzave të vendit³³. Tradita flet për këtë fakt tërthorazi, por në një mënyrë të tillë që nuk lë asnjë shteg dyshimi për ndikim të saj nga letërsia historike (krs. gojëdhënat për ndërrimin e fëmijëve midis së shoqes së Skënderbeut dhe një gruaje nga fisi i Vejzit)³⁴.

Berishët te Barleti përmenden si oficerë fisnikë e trima, të cilët kur marrin vesh fatkeqësinë e ushtrisë në Berat dhe sidomos, kur mësojnë rrebelimin e pabesinë e Mojsiut, vrapojnë për të forcuar rojet, për t'u dhënë zemër ushtarëve, për të qetësuar Skënderbenë me dashurinë, me besnikërinë dhe me solidaritetin e tyre³⁵. Por gojëdhënat me njoftimet e tyre flasin për një qëndrim krejt të kundërt³⁶. Dokumentat historike japin kufinj të zotërimeve të bashkëkohësve të Skënderbeut —

33) Barleti, f. 297.

34) *Kopështi letrar* 1918, nr. 2 f. 9.

35) Barleti, f. 335.

36) *Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun* XI, nr. 3/1-2.

të Dukagjinëve, Gjergj Arianitit, Mojsiut etj. Tradita nuk flet drejtpërdrejt për shtrirjen e këtyre kufinjve, por e shpreh këtë, mund të thuhet me shumë afëri, me anë të përhapjes së saj — me përhapjen e toponimeve dhe gojëdhënave për Dukagjinët, Gjorg Golemin, Mojsinë etj. pikërisht në zonat që përkojnë me trevat e zotërimeve të tyre. Fika të përbashkëta dhe diferencime në vijën e trajtimit nga burimet historike dhe tradita vihen re edhe në raste të tjera të veçanta (krs. kohën e zhvillimit të luftimeve në betejën e Albulenës³⁷ me gojëdhënat e Kokë Malçit³⁸; legjendat për parashikimin e forcës së mrekulueshme të heroit sipas Barletit³⁹ dhe traditës popullore⁴⁰ etj.)

Nga çka u tha më sipër kuptohet qartë se tradita gojore për Skënderbenë ka në shtratin e saj ngjarjet e kohës. Këto ngjarje e kanë frymëzuar dhe ushqyer atë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të pavarur nga faktorë të tjerë të jashtëm. Tradita i ka pasqyruar ngjarjet e faktet sipas mënyrës tradicionale të konceptimit artistik populor. Me kalimin nëpër shekuj gojëdhënat sigurisht janë pasuruar edhe me elemente të reja në drejtim të rritjes së gjesteve të heroit dhe të veprimeve luftarake të kohës së tij. Por në shtresën themelore të tyre mbetet gjithmonë fondi historik i ngjarjeve të periudhës përkatëse. Nga ky shkak të dhënat e traditës paraqiten me një interes të veçantë. Krahas dokumentave historike ato përbëjnë një tjetër burim shumë të rëndësishëm, që ndihmon në mënyrën e tij, për të nxjerrë në pah madhështinë e kësaj periudhe dhe për të hedhur dritë mbi probleme të ndryshme të saj.

Në përgjithësi mund të thuhet se tradita ndihmon për saktësimin e të dhënave lidhur me objekte dhe ngjarje themelore, që epen sidomos nga Barleti⁴¹ — për identifikimin p.sh. të kalasë së Stellushit e të Sfetigradit, për lokalizimin e betejave të Torviollit, Oranikut, të Mokrenës etj. Ajo furnizon të dhëna të rëndësishme mbi ngjarje e objekte, për të cilat nuk flasin dokumentat e kohës; ruan emrin e heroit në kala, qyteza e fortifikime, që nuk përmenden nga letërsia historike (si Kalaja e Skënderbeut në Shëngjin të Tiranës, në Valikardhë, Kastriot, Arras, Lurë etj.); shenjëzon toponime, krahina e fshatra që ka kaluar a ka pasur si bazë të veprimtarisë së tij Skënderbeu; evidencën figura luftëtarësh të panjohur si Kokë Malçin, Petro Petrosin, Gjokajt, Memenë etj., përmend ngjarje e fakte të paregjistruara nga burimet e shkrojtura, zbulon drejtimet e zonave intensive të ngjarjeve luftarake të kësaj periudhe, kufinj të zotërimeve të bashkëkohësve të Skënderbeut (Dukagjinëve, Gjergj Arianitit), etj.

Të gjitha këto meritojnë të bëhen objekt vëzhgimesh, analizash dhe konkluzioneesh me interes, për të zgjeruar kuadrin e kësaj periudhe të shkëlqyer të historisë sonë, sepse janë të dhëna autentike, të ruajtura nga vetë populli, të para dhe të interpretuara nga pozita popullore.

37) Barleti f. 372-373; F. Noli, *Historia e Skënderbeut*. Boston, 1921 f. 220.

38) Lkeni Hasit. *Gjergj Kastrioti Skendërbeu*. Albania 1906, nr. 2. f. 27-28 (MHFSH III f. 502), M. Sirdani. *Skanderbegu mbas gojëdhanash* f. 19.

39) Barleti. f. 50.

40) *Tregime dhe këngë popullore për Skënderbeun*.

41) I jemi referuar vazhdimisht humanistit tonë të shquar, jo vetëm se vepra e tij për Skënderbenë ka një vlerë monumentale, por më tepër nga fakti se ngjarjet dhe të dhënat toponomastike të tij, sikurse është vënë re gjatë këtij punimi, gjejnë mbështetje të madhe në traditën popullore, goftë edhe në raste, që paraqiten të diskutueshme (Stellushi, Sfetigradi, Oroniku, Mokrena etj.). Nuk mund të thuhet e njëjta gjë edhe për toponimet që shtohen p.sh. nga Biemi (Tornaçi, Otoneta etj.).

Tradita për Skënderbenë dhe kohën e tij nuk ka vetëm një vlerë të madhe njohëse. Bashkë me madhështinë e ngjarjeve gojëdhënat pasqyrojnë traditat tona të shkëlqyera, ndjenjat e mëdha, virtytet e larta morale e luftarake, forcat e pashtershme të masave tona popullore. Me thjeshtësinë karakteristike dhe gjallërinë e artit popullor ato të rrëmbejnë dhe të shpjen në atmosferën epike të «motit të madh të Arbërit», ku populli ynë përballoi me guxim rrezikun e një armiku të egër dhe të pabarabartë. Në to shkëlqen patriotizmi i masave tona popullore, energjitë e tyre revolucionare, vendosmëria dhe konsekuenca e luftës së paprerë kundër armikut; aty goditen përçarjet dhe tradhëtitë e brendshme, që buronin sidomos nga interesat dhe rivalitetet feudale, lartësohet bashkimi i popullit dhe lidhja e tij e ngushtë me udhëheqësin.

Duke ruajtur lavdinë e këtyre përpjekjeve dhe luftrave të mëdha ngadhnjimore, këto krijime artistike popullore mbetën përmes shekujve si një përmendore fitoresh, një gurrë e pashtershme admirimi (gjestesh dhe frymëzimi ndjenjash krenarie kombëtare, patriotizmi, përpjekjet për liri. Rrethanat e rënda të robërisë nuk mundën ta shuajnë famën e kësaj periudhe të lavdishme të historisë sonë, nuk mundën t'i shlyejnë nga mendja dhe zemra e popullit kujtimet e udhëheqësit të tij vigan. Ato jetuan nëpër shekuj si një çfaqje e gjallë e shpirtit epik të masave tona popullore e vullnetit të tyre për liri, si një flamur i madh lavdie dhe kushtrimi. Në krijimet artistike tradicionale për periudhën e Skënderbeut, ashtu si edhe në krijimet e tjera artistike popullore në përgjithësi, masat shihnin aftësitë dhe vitalitetin e tyre për të përballuar çdo vështirësi e rrezik, ndjenin gëzimin e fitoreve në rrugën e përpjekjeve të mëdha për qëllime jetike, rritnin me to ndjenjën e guximit, lëvronin virtytet, kalitnin ndjenjat e një patriotizmi të lartë.

Me të tilla ndjenja krenarie kombëtare, si stërnipër të Skënderbeut, luftëtarët tanë zbritën herë pas here nëpër fushat e betejës në vargun e paprerë të kryengritjeve për çlirimin kombëtar kundër pushtuesve turq, por edhe në çdo provë tjetër të rëndë që i vuri historia. Me kujtimet e kësaj periudhe të lavdishme dhe të figurës së Skënderbeut u frymëzuan edhe partizanët tanë trima në luftën e tyre heroike kundër pushtuesve fashistë e nazistë. Dikur të parët tanë nën udhëheqjen e Skënderbeut u bënë një barrikadë e pakalueshme kundër forcave të errëta, që kërkonin të vërshonin nëpër botë. Stërniprit e Skënderbeut sot, të udhëhequr nga idetë e ndritura të një Partie heroike, që trashëgon çdo gjë përparimtare nga e kaluara e popullit tonë, e kanë bërë atdhenë e tyre socialist fener ndriçonjës në të gjithë botën për lirinë, pavarësinë, socializmin, kështjellë të pamposhtur kundër forcave të regresit, kundër imperializmit dhe revizionizmit modern.

R é s u m é

LES CONTES POPULAIRES SUR L'EPOQUE DE SKANDERBEG

Dans l'exposé en question est brossé un cadre général de l'existence et des problèmes de pertinence des contes populaires sur la figure de notre héros national, Georges Kastriote-Skanderbeg. Les débuts de cette tradition nous les trouvons dès la parution de l'oeuvre connue de l'humaniste scutarin, M. Barletius (*Historia de vita et gestis Scanderbegi*, 1508-1510). Sur son existence durant les siècles parlent plusieurs auteurs albanais et étrangers (A. Sabelico, D. Franco, P. Budi, F. Bardhi, E. Tchéliébi, et tout particulièrement l'albanologue autrichien, J.G. von Hahn). Après un tableau général de ces contes parus dans des organes périodiques et des volumes particuliers avant la libération du pays, on fait ressortir le travail fait après la libération pour leur glane et leur publication. Du travail de recherche systématique fait durant cette période dans tout le pays on a glané 300 points environ 1300 éléments de cette tradition (contre 50 éléments publiés avant la libération). Ces matériaux enregistrés (et, durant les dernières expéditions aussi incisés sur magnétophone) chez des gens qui représentent la pure tradition populaire, font ressortir parfaitement la réalité de cette tradition dans les conditions de son existence contemporaine.

Les contes populaires de Skanderbeg ont leur propre spécifique qui les fait distinguer des légendes en général. Ils vivent sous la forme de légende (quand il est question notamment sur les gestes fantastiques de l'héros), dans celle d'un souvenir populaire (quand il est question d'événements et de faits historiques, d'informations sur les batailles, les forteresses, etc.), ou bien sous la forme d'une simple toponyme (noms de lieux, montagnes, roches, etc. rattachés au nom du héros).

Dans ces légendes, souvenirs et toponymes, les masses populaires ont saisi d'une façon spontanée les faits historiques, ont fixé leurs impressions, leurs grands sentiments, l'écho d'une période épique où notre peuple, conduit par le héros Georges Kastriote-Skanderbeg, est devenu la seule barricade importante contre la ruée turque, qui cherchait à submerger le monde. Ils ont vu le jour et ont vécu notamment dans les zones qui ont représenté le théâtre des batailles légendaires, des heurts sanglants avec l'ennemi (dans l'exposé sont données en détail ces zones). L'attention des masses populaires a été attirée par des événements et des faits les plus divers. L'auteur s'est essayé de faire une sorte de groupement thématique de ces éléments conservées de la façon traditionnelle: a) Données sur l'origine du lignage des Kastriote; b) naissance miraculeuse du héros; c) idéalisation de la figure de Skanderbeg, de ses qualités physiques et morales, de ses gestes d'éclat; d) informations sur les forteresses, les cités, les tours, les champs de bataille; e) légendes sur le déroulement même des batailles, sur la stratégie et la tactique suivie par Skanderbeg et sur la garantie des victoires; f) contes d'où émane tout particulièrement le patriotisme populaire, l'héroïsme, l'esprit militant, l'hardiesse, la fermeté des masses populaires et leurs liens étroits avec le chef; g) données sur l'Etat de Skanderbeg et sa résidence, sur son extension d'après la tradition orale, sur les forces militaires, les normes législatives, les constructions, etc.; h) toponymes sur Skanderbeg (montagnes, roches,

fontaines, empreintes du cheval du héros, grottes, etc. avec ou non des légendes explicatives): i) légendes sur d'autres figures contemporaines de Skanderbeg; Leke Dukagjine, Gjorg Golemi (Georges Arianite), Moïsi Golemi, Koke Malçi, Petër Petroshti, Gjob Bësari, le capitaine Sene, Vidan, les Gjokaj, etc.; j) dans un dernier chapitre sont réunies des légendes sur la mort de Skanderbeg — les contes sur ses conseils à la population à se tenir mutuellement, sur les armes qu'il confie à la terre, sur l'habillement de la population de gilets noirs comme expression de deuil national, etc.

Le caractère réaliste des événements dont il est question dans ces légendes, leurs localisation autour des lieux où se déroulent les événements, les conditions de la naissance et le but patriotiques qu'elles indiquent, ont donné à nos légendes une structure, un contenu et une fonction sociale toute particulière. Dans celles-ci il n'est point question de miracles du type des légendes hagiographiques. Prenant le point de départ des événements vécus dans une période historique relativement tardive et de la localisation dans une suite d'objets concrets — forteresses, cités, etc., elles ne portent pas dans leur contenu une grande explication fantastique. Le facteur fondamental dans la fusion de nos légendes, le ciment de leur construction, sont les motifs d'un patriotisme foncièrement de masse. Elles n'ont pas des influences religieuses. Dans aucune légende de Skanderbeg il n'est question de luttes partant de buts religieux, aucune des églises qui ont existé dans notre pays n'a tenu, d'après la tradition, son nom. Par un langage aussi simple que puissant, nos légendes attirent l'attention sur d'âpres combats qui ont lieu contre un ennemi barbare, qui détruit des centres et des villages épanouis, comme l'indique le toponyme Shkrete (un village au voisinage de Kruje, signifiant: (désert), la disparition de Varosh (naguère un des centres les plus épanouis de Skanderbeg), etc.; elles attirent l'attention sur des batailles où le sang des combattants rougit des campagnes, des vallées, qui ont gardé depuis ce temps l'épithète: Fusha e Kuqe (plaine rouge), Lqeri i Kuq (lac rouge), etc.

La vive fantaisie populaire, inspirée des gestes militaires du héros et de ses victoires, a idéalisé dans des dimensions géantes la force de son bras et de son épée: «Quand paraît l'arc-en-ciel, les vieux de Mati affirment qu'est parue l'épée de Skanderbeg». A Varosh se trouve une roche qu'il a taillée en quatre tranches pour essayer la résistance de la trempe de son épée. A Bulgize se trouvent au milieu de la plaine 5-6 grandes roches, dont il est dit qu'elles ont été faites rouler par Skanderbeg, afin d'anéantir les troupes turques qui voulaient investir Kruje du côté de la Dibra. Devant la porte de la forteresse de Kastriote se trouve une roche, que Skanderbeg a détachée de la montagne et l'a jetée contre les ennemis qui s'essaiaient d'enfoncer la porte de la forteresse. La Grotte de Pogjoj (Kukës) a une roche que Skanderbeg roulait comme une porte en fer pour bloquer ou livrer le passage. A Lure se trouve une pierre perforée par Skanderbeg, où il attachait son frein. A Trodhën de Mali Skanderbegut, à Mati, à Besh de Tirana, à Pishkash de Librazhd, et ailleurs, se trouvent les Tables de Skanderbeg, nom qu'on attribue à des pierres cyclopiques, sur lesquelles, dit-on, Skanderbeg appareillait pour ses soldats. Skanderbeg a découpé de son épée les gradins en pierre à Rrajce, pour dévancer les troupes de Ballabane arrivant d'Ohër (Ohrid): il a ouvert de son épée des galeries dans les forteresses de Valikardhe et dans la forteresse d'Elbasan pour prendre de surprise l'ennemi; il a volé

avec son cheval de Guri Kuq (Mati) au Col de Lure, du Mont de Deje au Mont de Kruje, de la Forteresse de Guribardhe (Petalba) à Bulqize, etc.

La fantaisie populaire a idéalisé, il est vrai, la figure de Skanderbeg par les tonalités hyperboliques, mais elles ne l'a point mystifiée, ne l'a jamais détachée du milieu vivant de la vie réelle. Ce héros qui a la possibilité de mouvoir les roches, d'arrêter les eaux du Drin ou bien de se jeter d'un massif à l'autre, vit parmi son peuple, parmi ses hommes. Skanderbeg se rend chez des amis et des compagnons d'après la coutume traditionnelle des Malessores, il s'entretient avec eux sur des «calebasses» dont le vin ne se termine jamais, des «pagnottes» qui rassassient les soldats, sur des tentes géantes qui réparent des rayons du soleil depuis Lesh à Kruje, etc.

D'autres sujets sont ceux des légendes sur Skanderbeg et sur ses contemporains, les informations sur les forteresses, les batailles. Mais une place importante est donnée dans l'exposé à la mise en évidence du fond réaliste de cette tradition, qui constitue un véritable trésor de la conscience patriotique de notre peuple. Sont indiqués en détail aussi les noms des lieux où vit cette tradition. Examinant leur présentation cartographique, on voit des itinéraires qui s'ancrent aux voies des invasions turques, itinéraires connus par les documents historiques. Nos créations populaires portent régulièrement l'écho d'événements vécus, de la gloire obtenues dans les mêlées avec l'ennemi sur les champs de bataille. Les contes populaires sur la période de Skanderbeg ont puisé là l'inspiration et le canevas. C'est pourquoi, à côté des documents historiques, ils constituent une source très importante, ils permettent à leur façon de faire ressortir la splendeur de cette période et à faire de la lumière sur des questions de toute sorte.

Portant la gloire des ces efforts et des grandes luttes victorieuses, ces créations artistiques populaires restent durant les âges un monument vivant de victoire, une source intarissable d'inspiration, de sentiments de fierté nationale, de patriotisme, d'efforts pour la liberté. Elles ont vécu dans les siècles comme une manifestation vivante de l'esprit épique des masses populaires, de leurs aspiration à la liberté, comme un grand drapeau de gloire et d'alerte pour de continuelles batailles de libération.